

Tiranë, 23.08.2023

KERKESE PER OFERTE

Projekti: “Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike”

Instituti e Studimeve Politike (ISP), do të implementojë projektin “Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike”, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) organizatë lider si dhe në partneritet me BIRN Albania dhe Qëndresa Qytetare (QQ). Ky projekt mbështetet financiarisht nga Ambasada Britanike.

Për realizimin e aktiviteteve të planifikuara për projektin ISP ka nevojë për dizenjimin dhe printimin e raportit final përmbledhës.

Subjektet/ personat e interesuar janë të lutur të japin ofertat e tyre për të cilat do të ketë procedurë vlerësimi dhe do të lidhet kontratë me ofruesin më të mirë. Ato duhet të kenë eksperiencë në fushën e disenjimit dhe shtypshkrimit.

Ftohen ato subjekte/persona të interesuar që përmbushin kriteret dhe kushtet e mëposhtme:

- Të ofrojnë shërbimin – disenjime dhe shtypshkrime.
- Të jenë fleksibël deri në variantin final dhe të ofrojnë garanci për dorëzimin e materialit brenda afatit dhe sipas specifikave teknike.
- Të lëshojnë faturë tatimore të fiskalizuar
- Të jenë në Tiranë

Specifikimet teknike

- Dizajni duhet të parashikojë vendosjen e figurave, shapes në varësi të informacionit për të reflektuar idenë.
- Format A4
- Letër e brendshme 150-170 gr.
- Kopertina me ngjyra 300 gr me plastifikim me ngjitje
- Nr. i faqeve 50-55

- Sasia 100 copë
- Materiali i brendshëm do të realizohet në bashkëpunim me ISP.

Subjektet e interesuara të dërgojnë:

- Ofertë financiare *e paraqitur në GBP, duke përfshirë TVSH firmosur/ vulosur*
- Certifikatë regjistrimi, nëse ofertuesi është subjekt tregtar/kompani
- Shembull të produkteve të ngjashme.

Fondi limit është 600 GBP për dizënjim raporti dhe 1500 GBP për printim raporti (me tvsh) .

Aplikimi duhet të dërgohen në një nga variantet, jo më vonë se data 14/09/2023 ora 12:00:

- në formë elektronike në adresën e e-mailit contactaips@gmail.com,
- me postë në adresën: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë/ ose dorazi me zarf të mbyllur pranë zyrave të ISP me mbishkrimin - Ofertë dizënjim dhe printim raporti-Projekti i zgjedhjeve, nr kontakti dhe adrese e saktë.
- Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Instituti i Studimeve Politike